



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2021
Nr. Dok. 202100556/2

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Kavajë.

Drejtuar: Kryekomisar Sali SKURRA
Shef i Komisarimit të Policisë Kavajë

KAVAJË

Për dijëni: Drejtues i parë Rebani JAUPI
Drejtori i Drejtorisë Vendore të Drejtorisë Tiranë

TIRANË

I nderuar z. Skurra,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Kavajë.

Inspektimi u krye në datën 07.04.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Ermonela Xhafa, Komisioner i MKPT-së, z. Besnik Deda dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Kavajë, z.Sali Skurra, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, grupi i inspektimit mori një informacion nga shefi i rendit të komisarariatit në lidhje me gjendjen në të cilën ndodhen ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë, si respektohen nga punonjësit e policisë të drejtat e personave të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar në mjediset e këtij komisarariatit, si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm, inspektoi në vend kushtet e dhomave të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë të komisarariatit, zhvilloi intervistë me personat që ndodheshin në këto mjedise në momentin e inspektimit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar apo të dyshuar për vepra penale, si dhe u njoh e administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Gjatë inspektimit, vëmendje e veçantë ju kushtua edhe zbatimit të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në mjediset e komisarariatit. U evidentua se, punonjësit e policisë ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe ruanin distancën fizike me njëri tjetrin. Në vende të aksesueshme (koridore) ishin vendosur dezinfektant për pastrimin e duarve. Gjithashtu, masa mbrojtëse ndaj COVID-19 ishin marrë dhe për personat kur hyjnë në dhomat e sigurisë dhe ato të shoqërimit, si dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Furnizimi me maska mbrojtëse dhe dezinfektantët për duart kryhej periodikisht çdo 3 muaj nga DVP Tiranë, por një pjesë e tyre ishin siguruar nga donacionet e ofruara nga subjekte private. Ambientet e zyrave të punës, automjetet e patrullimit, si dhe dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin dezinfektuar periodikisht nga një subjekt privat i kontraktuar nga DVP Tiranë, sipas një grafiku të miratuar në çdo 15 ditë.

Drejtuesit dhe punonjësit e policisë të komisarariatit, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë vizitës inspektuese që u zhvillua në ambientet e këtij komisarariati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për eliminimin e lagështirës në dhomat e sigurisë dhe në dhomat e shoqërimit.
2. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për plotësimin e dhomave të shoqërimit me tavolina pune dhe karrige për qëndrimin ulur të këtyre personave.
3. **Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi** për kryerjen e vizitës mjekësore brenda 12 orëve pas ndalimit/arrestimit të personit, ndërkohë mbetj problem dokumentimi i kryerjes së vizitës pasi ndihmësmjeku i DVP Tiranë nuk kishte hedhur në regjistrin e vizitave mjekësore shënimet sipas kartelës mjekësore për secilin person të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se disa nga rekomandimet nuk ishin realizuar dhe konkretisht:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin me vete të dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore të paisur me orënditë e nevojshme (krevat, tavolinë pune, karrige, raft për mbajtjen e kartelave mjekësore dhe frigorifer), si dhe me medikamente mjekësore për raste urgjente.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, instalimi i sistemit audio-viziv brenda kësaj dhome.

Në përfundim të inspektimit, u konstatua se në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarriatin e Policisë Kavajë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarriatin e Policisë Kavajë, mjedisi i shoqërimit ishte i ndërtuar përgjithsisht sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisarriatit dhe kishte 3(tre) dhoma shoqërimi. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më vehte për personat e rritur, femra dhe të mitur. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m secila prej tyre, duke garantuar sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme për mbajtjen dhe qëndrimin e të shoqëruarve. Secila nga dhomat ishte e kompletuar me orënditë e nevojshme si tavolinë pune dhe dy karrige (me këmbë të fiksuara në dysheme), për qëndrimin ulur të të shoqëruarve. Kapaciteti i dhomave ishte për mbajtjen e 10 personave të shoqëruar.

Dritaret e dhomave të shoqërimit kishin përmasa të tilla të cilat mundësonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ndërsa ndriçimi artificial, sigurohej nga rrjeti elektrik.

Të shoqëruarit qëndronin në dhoma të mbyllura me çelës, ndërsa dritaret e dhomave në pjesën e jashtme ishin të siguruara me rrjetë të hollë hekuri, për arsye sigurie të personave që qëndrojnë në këto ambiente.

Mjedisi dhe dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjiene-sanitare, por ato kishin nevojë për lyerje dhe dezinfektim të herë pas hershëm të ambienteve edhe më shumë tani që jemi në periudhën e emergjencës shëndetësore për shkak të COVID-19.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i përbashkët për meshkuj dhe femra dhe kishte ujë të rrjedhshëm.

U konstatua se, në ambientin e shoqërimit mungon dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar të rritur dhe për të miturit. Sipas informacionit, marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilat nuk ishin të monitoruara me sistemin audio-viziv të kamerave.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit, ishte instaluar një kamer për mbajtjen në vëzhgim të këtij mjedisi, por ajo **nuk** ishte në gjendje pune.

Në korridorin e këtij ambienti ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë.

Në mjedisin dhe në dhomat e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në momentin e kryerjes së inspektimit, në mjedisin e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person i shoqëruar. Ndërsa për periudhën Janar – Prill 2021 në ambientet e këtij komisariati ishin shoqëruar gjithsej 111 persona, nga të cilët 104 në moshë madhore dhe 7 të mitur.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kavajë, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar përgjithësisht konform normave, kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, që përcaktohen në procedurën standarde “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisarlatit, në kushte të plota ruajtje dhe sigurie. Ky ambient përbëhej nga 3(tre) dhoma sigurie, dhoma për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar dhe për takime me avokatin mbrojtës, zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, e cila njëkohësisht përdorej edhe si dhomë e mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore, tualet i përbashkët dhe dushi për larjen e trupit.

Dhomat e sigurisë ishin të ndara më vehte, një dhomë për personat e ndaluar/arrestuar të rritur, për femra dhe për të mitur. Çdo dhomë sigurie ishte me përmasa 4x3m dhe ishin të

ndërtuara me dhomë dhe paradhomë, të ndarë në mes me derë dhe skarë hekuri, si dhe kishin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde¹. Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen dhe sigurimin e 3(tre) personave. Për periudhën Janar – Prill 2021 në dhomat e sigurisë ishin mbajtur dhe siguruar gjithsej 30 persona, nga të cilët vetëm një person i mitur. Nga evidentimi i regjistrit, nuk ka patur situata të mbipopullimit mbi kapacitetin në dhomat e sigurisë.

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura me orenditë dhe materialet e nevojshme për qëndrim dhe jetesë normale si krevat për fjetje, batanije dhe jastëk. Në secilën dhomë kishte tualete me lavaman dhe çezëm me ujë të rrjedhshëm, ndërsa dushi për larjen e trupit kryhej në një ambient më vehte që ndodhej në korridorin e këtij ambienti. Në dhomat e sigurisë mungonin tavolina dhe karrige, që shërbejnë për mbajtjen dhe konsumimin e ushqimit, si dhe për qëndrimin ulur të këtyre personave.

Brenda dhomave të sigurisë ishin të instaluara butoni zile/sinjali, për kontaktin e të ndaluarit/arrestuarit me punonjësit e policisë në rast nevojë. Ndërsa në korridorin e ambientit të sigurisë ishte i instaluar telefoni fiks për kontaktin e punonjësve të shërbimit me zyrën operative të komisariatit.

Zyra e përgjegjës të dhomave të sigurisë ishte e përbashkët me dhomën që përdorej për vizitat mjeksore. Ajo ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si tavolinë pune, karrige, krevat, rafte për mbajtjen e dokumentacionit dhe kartelave mjeksore. Por, dhoma e mjekut nuk plotësonte kushtet për kryerjen e vizitave mjeksore, pasi ky ambient duhet të jetë i veçantë nga ambientet e tjera, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej dhoma për marrjen në pyetje nga përfaqësuesi i organit të prokurorisë të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe për takime me avokatin mbrojtës. Dhoma ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige prej druri me këmbë të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme, për të qëndruar ulur përfaqësuesi i organit të akuzës, avokati mbrojtës dhe i ndaluar/arrestuari.

Ambienti i sigurisë nuk kishte sistem ngrohje qëndror, por komisariati kishte marrë masa për sigurimin e pajisjeve elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Tualetet dhe dushi për larjen e trupit të personave të ndaluar/arrestuar, kishin furnizim me ujë të rrjedhshëm.

Korridori, hyrja e dhomave të sigurisë, dhoma e marrjes në pyetje dhe ambientet e jashtme të sigurisë, ishin të monitoruara nga 2 kamera, të cilat **nuk** ishin në gjendje pune.

¹ *Kreu VIII, pika 3.3 e procedurës standarde ku thuhet shprehimisht se: “Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë: sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve është jo më pak se 2.5 m”.*

Dhomat e sigurisë dhe mjediset e tjera që ndodheshin në ambientin e sigurisë, ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në kushtet e pandemisë së COVID-19, këto ambiente duhet të dizifektohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të jenë të pajisura me materialet mbrojtëse (maska, dizifektantë për pastrimin e duarve dhe doreza) për punonjësit e shërbimit të sigurisë, ashtu edhe për personat e arrestuar dhe të ndaluar, me qëllim parandalimin e përhapjes të kësaj pandemie në ambientet e komisariatit.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, ishin të afishuara posterat me të drejtat që gëzojnë personat e ndaluar/arrestuar, një kopje e të cilës ndodhej edhe në setin e dokumenteve që mbaheshin nga personat e arrestuar/ndaluar.

Në kohën e inspektimit, në ambientin e sigurisë ndodhej 1(një) person, i ndaluar nga policia për shkak të dënimit në mungesë me vendim të formës së prerë nga gjykata, por që kishte 14 ditë në këto ambiente, në pritje të urdhërit të DPB për transferimin e tij në një nga ambientet e I EVP-ve, për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe korrespondencës zyrtare, rezultoi se Komisarati i Policisë Kavajë kishte njoftuar zyrtarisht (me shkresë dhe email) brenda ditës Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për transferimin e personit të ndaluar në një nga I EVP-të, për vuajtjen e dënimit të mbetur sipas vendimit të formës së prerë nga gjykata. Por, DPB ende nuk kishte kthyer përgjigje në afatet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për transferimin e personit nga komisarati i policisë për në I EVP. Ndërkohë, që nga 16 ditë burg të mbetura sipas llogaritjeve të ditëve të dënimit nga vendimi i gjykatës, 14 ditë ky person i kishte vuajtur në dhomat e sigurisë të këtij komisariatit.

Ky rast është provë e evidente se, marrëveshja e bashkëpunimit midis institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për pranimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të personave me masë sigurie "Arrest me burg" dhe transferimin e të dënuarve me burgim deri në përfundim të vendimit, jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

Lidhur me këtë konstatim, autoritetet shtetërore përgjegjëse në Shqipëri, në përgjigje të rekomandimeve të CPT-së gjatë vizitës inspektuese nga data 20-30 Nëntor 2018², thuhet se procedurat dhe afatet për transferimin e të burgosurve të dënuar me vendim të formës së prerë nga Policia e Shtetit në ambientet e I EVP-ve, përcaktohet në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 "Për transferimin në I EVP të të paraburgosurve me masën e sigurisë "paraburgim" dhe të dënuarit me burgim me vendim përfundimtar në mungesë". Nga inspektimi rezultoi se kjo marrëveshje ende nuk po zbatohet në mënyrë efektive në përputhje me qëllimin e saj.

² Faqe 8 link: <https://rm.coe.int/16809cb571>

Gjatë inspektimit, në ambientin e sigurisë nuk u gjetën sende që shkaktojnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre

Në Komisaratin e Policisë Kavajë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër mbahej në zyrën e informacionit të komisarimit dhe ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, pasi regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit, shoqëroheshin për të qëndruar në dhomat e shoqërimit sipas ndarjes së tyre.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë. Të gjitha rubrikat e këtij regjistri ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë komisarati, evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ndodhej në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij, nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Nga kqyrja e regjistrave rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, në procesverbalin e përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore, ora e arrestimit në flagrancë të personave, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

U konstatua se në ambientin e sigurisë së këtij komisarati, ishte gjithë dokumentacioni që mbahet dhe administrohet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, sikurse përcaktohet në procedurën standarde³. Grupi i inspektimit u ndal në veçanti te regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të ndaluar/arrestuar. Ky regjistër ishte hapur sipas kërkesave të neni 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2021 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga shtetasit.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në kohën e inspektimit në Komisaratin e Policisë Kavajë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë, ndodhej vetëm 1(një) person i ndaluar.

³ *Kreu XI, pika 1 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe gjydhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit intervistoi personin që ndodhej në dhomat e sigurisë, i cili konfirmoi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë shoqërimit për në mjediset e komisariatit nga punonjësit e policisë, si dhe gjatë ditëve të qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Nga i intervistuari nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarit ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Shtetasi i intervistuar kishte dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe kishte kryer veprimet procedurale.

Të ndaluarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë me shërbimin katering, sipas normave për trajtimin me ushqim, të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore, kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit ose kopje e vendimit të formës së prerë të gjykatës, kopje e procesverbalit të kontrollit personal, si dhe kopje e kartës me të drejtat e tyre. Nga verifikimi i fashikujve që mbaheshin në dosjet personale të personave të ndaluar apo arrestuar, kopja e kartës me të drejtat e personave që ndodhen në dhomat e sigurisë, u jepeshin këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore, në momentin e komunikimit të masës të sigurisë “arrest me burg”.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Gjatë inspektimit, u konstatua se vizitat mjekësore të personave në ambientin e sigurisë, kryheshin brenda afatit 12 orë pas ndalimit/arrestimit të tyre, por nga mjeku/ndihmësmjeku i DVP Tiranë nuk ishte plotësuar në kohë regjistri i vizitave mjekësore, sipas shënimeve të bëra në kartelat mjekësore. Nisur nga ky konstatim, duket qartë se vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar nuk janë bërë brenda afatit 12 orë nga hyrja e tyre në ambientin e sigurisë nga mjeku i DVP Tiranë, siç edhe përcaktohet në procedurën standarde, dhe dokumentacioni mund të jetë plotësuar në mënyrë fiktive nga ana e mjekut. Ky shqetësim për Komisaratin e Policisë Kavajë, është përsëritur dhe është evidentuar edhe në inspektimin e mëparshëm të MKPT-së, ndaj është e nevojshme miratimi shtesë në organikë i një mjeku/ndihmësmjeku pranë DVP Tiranë (për shkak të

numrit të madh të komisariateve dhe shtrirjes gjeografike të tyre), që të përballojë kryerjen e vizitave dhe trajtimin mjeksor të personave të ndaluar/arrestuar, sipas afateve të përcaktuara në procedurën standarde⁴.

Në rastet e urgjencave ose rekomandimit të lëshuar nga mjeku i DVP Tiranë, personat e arrestuar/ndaluar me miratim të shefit të komisariatit, shoqëroheshin për kryerjen e vizitave mjeksore të specializuara pranë Spitalit Rajonal Kavajë. Të gjitha lëvizjet ishin të pasqyruara në librin e vizitave mjeksore.

Grupi i inspektimit, u ndal te procedurat që ndiqen nga punonjësit e policisë në rastet e shoqërimit për në mjediset e policisë të personave të mitur. Lidhur me këtë, në këtë komisariat ishte hapur regjistri për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjithashtu, u evidentua nga regjistri se marrja në pyetje dhe intervistimi i tyre, kryhej në prezencë të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe psikologut. Psikologu ishte i siguruar nga Bashkia Kavajë dhe shkolla e mesme e këtij qyteti. Ndërsa në rastet më specifike për nevoja të hetimit, asistonte psikologjia në organikë të DVP Tiranë. Avokatët mbrojtës siguroheshin nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Kavajë, punonjësit e policisë i kryenin veprimet proceduriale me të shoqëruarit në zyrat e punës së tyre, në mungesë të një dhome më vehte dhe të pajisur me orenditë e nevojshme si tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të të shoqëruarve, gjatë seancës të intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre. Zyrat e punonjësve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Ndërsa, në ambientin e sigurisë ishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës, si edhe për takim me avokatët mbrojtës. Ky ambient ishte i monitoruar me kamera, gjatë gjithë veprimeve proceduriale që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore me personat e arrestuar.

Sistemi i kamerave të komisariatit, nuk ishte në gjendje pune, që prej një viti. Nga ana e Komisarlatit të Policisë Kavajë, me shkresë zyrtare nr.425 prot., datë 28.01.2021 i ishte dërguar një informacion DVP Tiranë, ku ngrihej shqetësimi se kamerat e vëzhgimit ishin jashtë funksionit. Ky shqetësim ishte ngritur në mënyrë të përsëritur edhe në rrugë elektronike nga ky komisariat në datat 29.06.2020, 02.11.2020, 13.01.2021 dhe përgjigja e drejtorisë ka qenë se: “është në dijeni të problematikës për Komisarlatin e Policisë Kavajë”, por ende nuk është marrë asnjë masë për rregullimin e këtij sistemi.

⁴ *Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit⁵.

Gjithashtu, në Komisaratin e Policisë Kavajë, mungonte mjedisi për intervistimin e personave të miturve në konflikt me ligjin, i cili duhet të jetë një ambient i veçantë dhe i pajisur me kushte të përshtatshme pune dhe qëndrimi. Dhe në këtë rast, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim i panevojshëm i fëmijëve.

Nga monitorimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe intervista me personin e ndaluar, si dhe punonjësit e policisë të këtij komisarati, u konstatua se, personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar ishin të njoftuar që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës privat, të kërkonin ndihmë juridike për t'ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut.

Në këtë komisarati, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurës standarde për shoqërimin në mjediset e policisë, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Nga inspektimi, rezultoi gjithashtu se, për personat e shoqëruar mbahej nga punonjësi i policisë një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”.

⁵“Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet dhe të mbajë me vehte një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, procesverbalin e dorëzimit të sendeve personale dhe letra për njohjen me të drejtat që gëzojnë këta persona, gjatë qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Në rastin e ndalim/arrestimit të personave me shtetasi të huaj, ju ofrohet dhënia e deklaratës ku parashikohen të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar e përkthyer në 6 gjuhë të huaj.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme organizative, në bashkëpunim me DPB për transferimin brenda 24 orëve, të personave të ndaluar që janë me vendim të formës së prerë të gjykatës, nga Komisariati i Policisë për në IEVP-të.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien dhe mbajtjen në funksion të plotë të sistemit audio-viziv me kamera në Komisaratin e Policisë Kavajë, i cili shërben për mbajtjen në vëzhgim të ambientit të shoqërimit dhe ambientit të sigurisë, si dhe për këqyrjen e veprimeve të punonjësve të policisë në këto ambiente dhe në dhomën e marrjes në pyetje apo gjatë intervistimit të personave që shoqërohen në mjedisit e këtij komisariati.
3. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, para se të kalojnë në ambientin e sigurisë dhe instalimin e sistemit audio-viziv brenda kësaj dhome.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një mjedisi të veçantë për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin, ambient i cili duhet të ketë materiale informuese dhe të jetë i pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina pune për punonjësit e policisë dhe ndenjësë për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës.

5. Marrjen e masave të menjëhershme organizative, për kryerjen e vizitave mjekësore brenda 12 orëve të ndalimit/arrestimit të personave nga mjeku i DVP Tiranë, si dhe plotësimin në kohë të dokumentacionit mjekësor (regjistrin dhe kartelat mjekësore) për secilin person të ndaluar/arrestuar. Të bëhet një hetim i thelluar për zbatimin e kësaj kërkesë, si dhe të nxirren përgjegjësitë ndaj personave që nuk e kanë ushtruar këtë detyrim në afatet kohore të përcaktuara në procedurën standarde.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin në ambientin e sigurisë të dhomës me vehte të mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, paisjen e saj me orenditë e nevojshme, si dhe me medikamente mjekësore për nevojat urgjente.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës me të drejtat personave të shoqëruar që në momentin e shoqërimit të tyre në mjediset e komisariatit të policisë, si dhe vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar brenda në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është efektive nëse janë të vendosura vetëm në korridorin e ambientit të shoqërimit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ermonela XHAFA